



*“Trajnim në përshtatje me nevojat reale”*

# **R A P O R T**

**i**

**Veprimtarisë së**

**Institutit të Trajnimit të Administratës Publike**

2007

**PËRMBAJTJA:**

✚ *Hyrje*

- *Objektivat strategjikë dhe zhvillimi institucional*

✚ *Trajnimi i ofruar*

✚ *Kurrikula të reja*

✚ *Trajnerët*

✚ *Bashkëpunimi me projekte*

✚ *Indikatorët*

✚ *Raportimi Financiar*

✚ *Konkluzione & Rekomandime*

✚ *Shtojca 1 / Realizimi sipas objektivave*

✚ *Shtojca 2 / Treguesit*

## HYRJE

Veprimtaria e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike për periudhën Janar – Dhjetor 2007 është zhvilluar në përputhje të plotë me **Planin e Punës për vitin 2007** dhe **Planin e Trajnimit 2007**.

Tërësia e masave të marra këtë vit për ndryshime dhe përmirësime në organizimin dhe realizimin e veprimtarisë trajnuese, ka synuar të sigurojnë një **“Trajnim në përshtatje me nevojat reale të Administratës Publike”**.

Struktura dhe përmbajtja e veprimtarisë trajnuese janë konceptuar dhe janë zbatuar me qëllim që Instituti i Trajnimit të Administratës Publike të ofrojë shërbime sa më pranë kërkesës dhe kujdesit për klientët dhe me një cilësi të lartë.

Referuar dokumentave kryesore, përpjekjet e stafit të Institutit për vitin **2007** janë fokusuar në **cilësinë**, si në përgatitjen e materialeve trajnuese (kurrikulave), ashtu edhe në përzgjedhjen e ekspertëve, në zhvillimin e metodave trajnuese bashkëkohore dhe në hartimin e procedurave përkatëse.

## OBJEKTIVAT DHE ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

Veprimtaria e Institutit për vitin 2007 synoi të përmbushë këto objektiva kryesore:

- Plotësimin e kërkesave për trajnim të nëpunësve civilë të krijuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit e nënshkruar nga Shqipëria.
- Plotësimin e nevojës për trajnim brënda Shërbimit Civil të Shqipërisë, sidomos në fushën e aftësive menaxheriale dhe funksionale
- Zhvillimin e Institutit si një organizatë e orientuar nga kërkesa, klienti dhe kujdesi për klientin.
- Përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve të brendshme të Institutit.

Për të arritur detyrat që përfshihen në Prioritetin Strategjik **“Përgjigje efektive ndaj nevojave për zhvillim të shërbimit civil”**, vëmendje më e madhe ju kushtua përmbushjes së objektivave 1 dhe 2 si më poshtë:

### **1. Plotësimi i kërkesave për trajnim të nëpunësve civilë të krijuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit e nënshkruar nga Shqipëria.**

Për plotësimin e këtij objektivi është punuar për përcaktimin dhe realizimin e trajnimeve mbi çështje të BE-së, në përshtatje me zhvillimet e procesit dhe nevojat që rrjedhin nga zbatimi MSA për Shqipërinë. Një vend të rëndësishëm ka zënë edhe futja e kurikulave të reja për çështje të integritimit europian.

Gjithashtu duhet theksuar se kurset e trajnimit janë në përshtatje me nevojat e identifikuar për trajnime dhe në funksion të procesit të integritit europian. Programet e trajnimit të zhvilluara deri tani kanë konsultuar eksperiencën përkatëse europiane dhe rajonale dhe është punuar vazhdimisht për europianizimin e kurikulave.

Gjithashtu referuar nevojave dhe në zbatim edhe të strategjisë të trajnimit për çështje të BE-së që në planifikim ka patur një rritje të peshës specifike të trajnimeve për “**Çështje të Integritit Europian**” në krahasim me vitin 2006. Kjo rritje është në masën 70% përse i përket kurseve të zhvilluara (nga 16 në vitin 2006 në 26 kurse në 2007). Gjatë vitit 2007 janë hartuar dhe zhvilluar tematikat e reja si “Implikimet praktike në katër Liritë e tregut”, “Politikat sociale të BE dhe Shqipëria”, “Politikat gjinore të BE dhe Shqipëria”, “Politikat europiane në lidhje me migracionin dhe legjislacioni përkatës”.

Në fund të periudhës së parë gjashtëmujore u realizua një vlerësim i njohurive në lidhje me trajnimin “*Përgatitje për Programin e Europës*”, zhvilluar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike me pjesëmarrës në këtë kurs në vitin 2006, nga Ministri të ndryshme. Rezultatet e këtij vlerësimi treguan se niveli i përvetësimit të njohurive në lidhje me kursin bazë të BE, nga ana e nëpunësve të administratës publike të intervistuar ishte në nivele të kënaqshme dhe konstatohet se:

- Ky kurs është i mirëpritur nga Nëpunësit Civilë
- Kursi është formues e gjithëpërfshirës dhe kërkon ndjekje më të madhe nga ana e Nëpunësve Civilë.
- Kursi përbën një bazë dhe kushtëzon ndjekjen efektive të kurseve të tjerë specifike për çështje të BE-së.
- Niveli i dijeve të përvetësuar është i kënaqshëm (mbi 50% të përgjigjeve ishin të sakta)
- Përgjigjet pozitive të pyetjeve që kanë lidhje me integrimin e vendit tonë dhe MSA kanë tregues më të lartë se të tjerët që lidhen me institucionet apo politikat e BE
- Treguesit më të lartë i kanë ministritë që merren direkt me proceset integruese evropiane (MPAU, MD, MASH etj) apo që kanë në background e tyre një arsimim ligjor ose të përafërt të lidhur me të
- Kërkohej të sqarohet se kursi i trajnimit nuk është një leksion por një mjedis ku shkëmbehet eksperiencë (megjithëse ky trajnim ka karakter formues, pra ana teorike është disi dominante)
- Do të rritej impakti nqs do të shpërndahej literaturë suplementare për të cilën do të punohet në të ardhmen

Qëllimi është gjithashtu të mendohet për një shtim të numrit të trajnimeve për këtë program në vitin 2008 me qëllim që tu jepet mundësi sa më shumë Nëpunësve Civilë të ndjekin këtë kurs trajnimi të nevojshëm, si në nivel qëndror ashtu edhe për autoritetet vendore.

## **2. Plotësimin e nevojës për trajnim brenda Shërbimit Civil të Shqipërisë, sidomos në fushën e aftësive menaxheriale dhe funksionale**

Për realizimin e detyrave specifike në funksion të arritjes së këtij objekti, janë përgatitur dhe zbatuar kurse trajnimi mbështetur tek aftësitë dhe për funksione specifike në shërbimin civil. Paketa e parë trajnuese “**Zhvillimi i aftësive menaxhuese dhe funksionale**” mbështet të gjithë nivelet dhe funksionet specifike sipas niveleve në administratën publike aktuale (**Plani i trajnimit 2006-2008**).

Kështu gjatë periudhës janë zhvilluar kurset e parashikuara në paketën e parë trajnuese për nëpunësit civilë në administratën publike, pushtetin vendor dhe për administratë fiskale (tatimet dhe doganat)<sup>1</sup>

Për të arritur detyrat që përfshihen në Prioritetin Strategjik “**Përmirësim i cilësisë së shërbimeve dhe produkteve**”, vëmendje më e madhe ju kushtua përmbushjes së objektivave 3 dhe 4 si më poshtë:

## **3. Zhvillimin e Institutit si një organizatë e orientuar nga kërkesa, klienti dhe kujdesi për klientin.**

Arritja e këtij objekti ka synuar në rradhë të parë hartimin dhe zhvillimin e programeve trajnuese që janë në përputhje me modelin që mbështetet tek klienti.

Për këtë qëllim në rradhë të parë u vendosën bazat e veprimtarisë duke hartuar dhe vënë në zbatim dokumentet e punës së ITAP :

- Rregullore e brendshëm dhe anekset përkatëse.
- Procedurat e punës
- Menaxhimi elektronik i dokumentacionit

Ndër të tjera vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe trajnimit të stafit në lidhje me shërbimin proklient. Ky trajnim është realizuar në gjashtëmujorin e dytë nëpërmjet projektit CARDS 2004 dhe asistencës teknike që ofroi ky projekt edhe për këtë qëllim.

Çdo menaxher trajnimi zhvillon kontakte të vazhdueshme me institucionet për nevojat e tyre në përputhje me objektivat e tyre strategjike dhe komunikon me drejtoritë e burimeve njerëzore për mbarëvajtjen e procesit të trajnimit.

Bordi këshillimor gjithashtu ka funksionuar si institucion i përfaqësimit të klientëve tanë dhe ka diskutuar për çështje të orientimit të ITAP si një organizatë e orientuar nga klienti dhe kujdesi për të.

Gjatë vitit 2007, në kuadër të bashkëpunimit me grupet e interesit dhe institucione të administratës publike, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike organizoi Forumin

<sup>1</sup> Bashkëngjitur lista e kurseve dhe treguesit e QTP dhe QTF (Shtojca 2)

**“Cilësia në Trajnimin e Administratës Publike”** në 14 Nëntor 2007 që synonte analizën e cilesisë së përmbajtjes dhe trajnimit si edhe ofrimin e shërbimit të trajnimit sa më cilësor dhe sa më afër nevojave të klientëve tanë. Në forum pjesëmarrësit ishin përfituesit e shërbimeve të Institutit nga Ministritë e linjës, Universiteti i Tiranës dhe trajnerë. Krahas kësaj janë të vazhdueshme takimet me grupet e interesit dhe përfituesit e trajnimit në ministri dhe institucione të interesuara.

Gjithashtu në bashkëpunim me Projektin Cards 2004, komponenti 2, që ka filluar të zbatohet nga Shtatori 2007 dhe do të përfundojë në shkurt 2008, po punohet për të hartuar një set manualesh, pyetsorësh që do të ndihmojnë në cilësinë e procesit të trajnimit, identifikimin e treguesve të cilësisë dhe standartet e nevojshme për një shërbim cilësor ndaj klientëve tanë si edhe rritjen e profilit të institucionit .

Në përputhje me nevojat e klientëve janë përfshirë në programet e trajnimit kurrikula të reja si: *“Politikat gjinore të BE-së”*, *“Respektimi i të drejtave të Minoriteteve”*, *“Integrimi gjinor”*, *“Parandalimi i konfliktit të interesit në Administratën Publike”* dhe në fushën e pushtetit vendor të mbështetur nga Fondacioni SOROS *“Qeverisja me pjesmarrje”*, *“Menaxhimi i taksës së biznesit të vogël”* etj.

#### **4. Përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve të brendshme të Institutit.**

Ky objektivi është vlerësuar si shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave të ITAP parashikuar në planin e zhvillimit të institucionit për periudhën 2006-2009 . Për këtë po punohet për hartimin e një programi trajnimi në përputhje me nevojat për trajnim të stafit menaxherial të ITAP, që do të nxisin zhvillimin individual dhe të institucionit.

Në kuadër të Projektit CARDS 2004, një nga komponentet e të cilit është edhe *“Zhvillimi i kapaciteteve të ITAP dhe përmirësimi i sistemit të trajnimit, metodologjisë dhe cilësisë”* , u punua për realizimin e një plani aktiviteteve dhe trajnimi në këtë drejtim që në një farë mënyre ndihmoi edhe në rritjen e kapacitetit të stafit të institucionit.


Gjithashtu bazuar në detyrimin për zhvillimin e kapaciteteve të stafit të ITAP për çështje të Integritetit Europian u zhvillua trajnimi 5 ditor *“Programi i Europës”*, me mbështetjen e Qendrës së Studimeve Europiane.

Realizimi i këtyre objektivave u realizua sipas hapave të parashikuara në Planin e Punës 2007, ku detyrat janë të specifikuar për çdo prioritet strategjik. Gjithashtu pranë institutit u ngrit dhe funksionoi Grupi i Monitorimit të hapave të progresit dhe realizimit të objektivave, bazuar në Planin Strategjik 2006-2009 dhe Planin e Punës 2007, i cili ndoqi në vazhdimësi realizimin e objektivave dhe detyrave përkatëse.

Gjithashtu është punuar edhe për realizimin e objektivave të parashikuara në planin strategjik të ITAP 2006-2009, të cilat do të realizohen në fund të periudhës katër vjecare që kanë të bëjnë me:

- *Arritjen e "statusit të ekselencës", i njohur nga klientët dhe publiku*  
Vend të rëndësishëm për arritjen e këtij objekti zënë kontaktet e Institutit me organizma dhe institucione të administrimit publik dhe trajnimit të Administratës publike si edhe pjesmarrja në aktivitete rajonale dhe më gjerë.
- *Në lidhje me Prioritetin strategjik 4- menaxhimi i financave është punuar që:*  
-Plani financiar i Institutit të përfshijë edhe çështje të marketingut për të gjitha aktivitetet e ITAP-it dhe për këtë janë parashikuar në planin financiar të vitit 2007 përveç trajnimit edhe aktivitete të tjera (trajnim dhe zhvillim stafi, konferenca etj)  
- Sigurimi i mbështetjes dhe përfshirjes në projekte të ndryshme me komponentë trajnimi dhe për këtë po bashkëpunohet në projekte të ndryshme me komponentë trajnimi si me Fondacionin "Shoqëria e Hapur" për Shqipërinë (SOROS) për pushtetin vendor, me UNDP në zhvillimin e kurseve të trajnimit mbi "Çështje të Përkatësisë Gjinore" dhe "Respektimi i të Drejtave të Minoriteteve", Delegacionin e Komisionit të Bashkimit Europian nëpërmjet Cards 2004, asistencë teknike për stafin e ITAP dhe për zhvillimin e sistemit të trajnimit.  
-Përmirësimi i marketingut të Institutit, që do të ketë një impakt edhe në rritjen e imazhit të organizatës, ku një vemendje e vacantë i është kushtuar rritjes së kontakteve me institucione homologe edhe jashte vendit, zhvillimit të aktiviteteve rajonale dhe vendosjes se kontakteve të reja të cilat i shërbejnë direkt rritjes së imazhit të ITAP me institucionet e trajnimit të administratës publike nga vendet e rajonit si edhe bashkepunimeve me ReSPA (Shkollen Rajonale të Administratës Publike) si dhe NISPACEE (Rrjetin e shkollave dhe institucioneve të administrates publike për Europën Qendrore dhe Juglindore)<sup>2</sup>.

### TIPET E TRAJNIMIT TË OFRUAR



Me zbatimin e Planit të Trajnimit për Vitin 2007, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike synon të realizojë qëllimin kryesor të veprimtarisë së tij trajnuese:


***“Rritjen e aftësive profesionale dhe përmirësimin e njohurive baze të nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës, të përmbushë sa më mirë qëllimet e tij dhe të institucionit”,***  
dhe njëkohësisht, synimet e përcaktuara për Vitin 2007:

<sup>2</sup> Bashkëngjitur **shtojca** 1- Realizimi i detyrave sipas objektivave

1. Përmirësimin e aftësive menaxhuese dhe funksionale të nëpunësve civilë në funksion të procesit të modernizimit dhe reformës në Shërbimin Civil të Shqipërisë.
2. Pajisjen e nëpunësve civilë me njohuri të mjaftueshme dhe aftësi përkatëse, me qëllim aplikimin efektiv të legjislacionit të përafuar si dhe angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit.
3. Përmirësimin e aftësive menaxhuese dhe profesionale të nëpunësve të administratës fiskale, në mbështetje të reformave të ndërmarra në këtë administratë, nëpërmjet trajnimeve në përshtatje me prioritetet dhe nevojat përkatëse, të identifikuar nga bashkëpunimi me administratën fiskale.

### **QENDRA E TRAJNIMIT TË PËRGJITHSHËM**

Programet dhe modulet e trajnimit që kanë në qendër zhvillimin e aftësive menaxhuese dhe funksionale të nëpunësve civilë janë përfshirë në Paketën e Parë të trajnimit:



#### ➤ **Trajnim për përmirësimin e aftësive menaxhuese dhe funksionale.**

Përmbajtja dhe realizimi i kësaj pakete për vitin 2007 iu drejtohet 7 grupeve të synuara, për nivelet menaxhuese të Shërbimit Civil dhe disa grupeve me funksione specifike dhe tematikave përkatëse :

1. Menaxherë të nivelit të mesëm (drejtorë drejtorish)- Programi i menaxhimit të Lartë
2. Menaxherë të nivelit të ulët (përgjegjës sektori) - Programi i menaxhimit operativ
3. Drejtorë, Përgjegjës sektorësh dhe specialistë të drejtorive të burimeve njerëzore- Programi i zhvillimit të Burimeve Njerëzore
4. Specialistë dhe specialistë të lartë - Programi i Zhvillimit Funkcional
5. Specialistë dhe specialistë të lartë të drejtorive juridike - Programi për Juristët
6. Nëpunës civilë që merren me integrimin në BE - Përgatitje për Programin e Europës
7. Nëpunës që merren me çështje të financave dhe buxhetimit - Programi i menaxhimit financiar



Programet e trajnimit për menaxherët e nivelit të lartë të planifikuara brenda paketës së pare trajnuese, nuk u realizuan dot për arsyen e vështirësive objektive në përgatitjen e kursit të Trajnimit të Trajnereve.

Per vitin 2007, brenda paketës së parë u realizuan **41** kurse, në **337** ditë trajnimi, duke trajnuar **634** nëpunës civilë.

➤ **Trajnim në Pushtetin Vendor.**

*Duke konsideruar rëndësinë e madhë të trajnimit në fushën e pushtetit vendor Instituti i Trajnimit të Administratës Publike ka zhvilluar një sërë trajnimesh drejtuar grupeve të ndryshme dhe duke përfshirë tema të ndryshme si:*

- *Zhvillimi strategjik;*
- *Decentralizimi administrativ;*
- *Legalizimet;*
- *Funksionet e përbashkëta dhe të Deleguara;*
- *Menaxhimi i Pronave Publike;*
- *Menaxhimi i taksës së biznesit të vogël;*
- *Qeverisje e mirë me pjesmarrje qytetare;*
- *Funksionet dhe Detyrat e Sekretarit të Këshillit*
- *Programi i Zhvillimit Funkcional;*
- *Programi i Europës*

Për vitin 2007 , u realizuan **34** kurse, në **71** ditë trajnimi, duke trajnuar **601** nëpunës civilë

Programet dhe modulet e trajnimit që kanë në qendër **çështje të Integritimit në BE**, janë përfshirë në Paketën e Dytë të trajnimit:

➤ **Trajnim në lidhje me Çështje të Integritimit në BE**

Tematikat e zhvilluara në lidhje me trajnimet specifike për çështje që lidhen me integrimin europian, për vitin 2007 janë:

1. Impakti i Instalimit të Tregtisë së Lirë në Shqipëri *(Nëpunës civilë që merren me çështje financiare, tatimore, licensimi, doganore dhe me projekte në ministritë e linjës).*
2. Drejtësia dhe Punët e Brendshme të BE *(Nëpunës civilë që merren me çështje të përafrimit të legjislacionit në çështje të drejtësisë dhe punëve të brendshme, probleme ligjore dhe procedurat e punesimit dhe lëvizjes së punëtoreve, migracionit, probleme ligjore dhe procedura financiare, monitorim-vlerësimi, dhe asistencave të ndryshme teknike përkatëse)*
3. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë e Bashkimit Evropian. *(Nëpunës civile që merren me marrëdhëniet me jashtë, shprehjen dhe analizën e politikave dhe me menaxhimin e ciklit të projektit (sidomos MPJ, MPCSSHB)*
4. Aktorët negociues, aftësitë e teknikat negociuese dhe lobizimi me Bashkimin Evropian në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit *(Negociatorët dhe grupet e tyre të punës, juristët dhe nëpunësit civile të angazhuar në përafrimin e legjislacionit)*

5. Politika e Konkurrencës e Bashkimit European dhe Shqipëria (*Nëpunës civilë nga METE, MF, MD, etj që merren me çështje të konkurrencës*)
6. Akreditimi, Metrologjia dhe Kalibrimi në Bashkimin European dhe Shqipëria (*Nëpunës civilë që merren me procedurat e dhënies së licensave, juristë dhe ekonomiste që merren me akreditimin, metrologjinë dhe kalibrimin*)
7. Standartizimi dhe Certifikimi në Bashkimin European dhe Shqipëria (*Nëpunës civil që merren me procedurat e dhënies së licensave, procedurat e standartizimit dhe certifikimit*)
8. Politika e Përbashkët Bujqësore e Bashkimit Evropian dhe Shqipëria (*Nëpunës Civilë nga MBUMK si dhe nga ministritë e linjes që merren me licensimet dhe standardizimet te sipërmarrjeve ushqimore dhe në mbrojtje të konsumatorit*).
9. Politikat sociale të BE dhe Shqipëria (*Nëpunës civilë që merren me politika sociale*)
10. Politikat gjinore në BE dhe Shqipëria (*Nëpunës civilë që merren me politika gjinore*)
11. Implikimet praktike në lidhje me 4 liritë e tregut (*Nëpunës civilë që merren me lëvizjen e lirë të tregjeve dhe mallrave*)
12. Programi i Trajnimit te Trajnerëve për Çështje të BE-së duke krijuar një grup të përgatitur në njohuri dhe aftësi të reja trajnerësh mbi BE dhe çështjet e integritimit European, duke realizuar kështu edhe një objektiv të parashikuar në planin e vitit 2007, me qëllim rritjen e kapaciteteve trajnuese në këtë fushë
13. Migracioni dhe direktiva europiane (nëpunës të zyrave rajonale të punësimit), një kurs i përcaktuar në planin e trajnimit në kuadër te Strategjisë Kombëtare të Migracionit të Qeverisë Shqiptare.

Për vitin 2007, brenda paketës së dytë u realizuan **26** kurse, në **44** ditë trajnimi, duke trajnuar **328** nëpunës civilë.

### ➤ **Kursi i trajnimit “Prezantim me Administratën Publike”**

Ky kurs trajnimi, i përgatitur për nëpunës civilë në periudhën e provës dhe i detyrueshëm për ta, në vitin 2007, u trajtua si kurs me vehte, jashtë Paketës së Parë trajnuese, pasi:

- Është një kurs i rëndësishëm, prezantues, me kohezgjatje 11-ditore, që nuk ka si qëllim synimin kryesor të kësaj pakete, rritjen e aftësive menaxhuese dhe funksionale të pjesëmarrësve
- Pjesëmarrësit në këtë trajnim janë nëpunës civilë të të gjitha niveleve në administratën publike
- Planifikimi dhe kalendari i zhvillimit të kursit është në varësi edhe të emërimeve në administratën publike

Për vitin 2007 u zhvilluan **10** kurse të tilla, në **110** ditë trajnimi dhe u trajnuan **191** nëpunës civil në periudhën e provës .

## ➤ *Trajnime sipas nevojave*

Në funksion të nevojave për trajnim, që sugjerojnë zhvillimet në administratën publike dhe kërkesat e institucioneve dhe agjensive të ndryshme, Instituti (Qendra e Trajnimit të Përgjithshëm) ka zhvilluar edhe **“Trajnime sipas nevojave”**, në këto tematika :

- *Vlerësimi i ndikimit të ndërhyrjeve legislative*
- *Masat disiplinore*
- *Kontratat administrative*
- *Vlerësimi i arritjeve individuale ( për Ministrinë e Brendshme)*
- *Parandalimi i konfliktit të interesit në Administratën Publike (bashkëpunim me ILDKP)*


Për vitin 2007, u realizuan **26** kurse sipas nevojave, në **46** ditë trajnimi, duke trajnuar **815** nëpunës civilë.

Për vitin 2007 ,totali i trajnimeve të realizuara nga Qendra e Trajnimit të Përgjithshëm është **141** kurse , në **544** ditë trajnimi (nga **470** të planifikuara) me **2582** pjesmarrës.

## **QENDRA E TRAJNIMIT FISKAL**

### ➤ *Trajnime për Administratën Tatimore dhe Doganore*

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave organizoi trajnime të bazuara në programe dhe module trajnimi që i drejtohen grupeve specifike, të synuara të administratës fiskale :



## **Kurse trajnimi për inspektorë të rinj, në periudhë prove:**

- *Njohuri bazë mbi punën dhe zbatimin e legjislacionit tatimor - (Prezantim me administratën tatimore)*
- *Kontabiliteti dhe tatimet ( Kurs baze)*
- *Kontrolli tatimor dhe përdorimi i manualit të kontrollit*

## **Kurse trajnimi për inspektorë tatimore**

- *Ligji mbi Akcizën dhe probleme që lidhen me zbatimin e tij në praktikë*
- *Mbledhja dhe kontrolli i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe probleme që lidhen me këtë proces.*
- *Tatimi mbi vlerën e shtuar*
- *Njohuri që lidhen me përdorimin e STI nga punonjësit tatimorë*
- *Procedurat e administrimit të sistemit të integruar të tatimeve*

## **Kurse trajnimi për kryetare dhe zv. kryetarë të degëve tatimore**

- *Procedurat për përcaktimin e objektivave të punës dhe vlerësimi i performancës së stafit*
- *Plotësimi, përpunimi dhe raportimi i të dhënave financiare e statistikore, në deget e tatimeve*
- *Ligji mbi Akcizën dhe probleme që lidhen me zbatimin e tij në praktikë*
- *Mbledhja dhe kontrolli i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe probleme që lidhen me këtë proces.*
- *Shërbimi ndaj tatimpaguesve*

## **Kurse trajnimi për përgjegjës sektori dhe përgjegjës zyre në degët tatimore**

- *Menaxhimi në degët tatimore dhe reforma në administratën tatimore, për mirëadministrimin e mbledhjes së tatimeve*
- *Procedurat për përcaktimin e objektivave të punës dhe vlerësimi i performancës së stafit*
- *Plotësimi, përpunimi dhe raportimi i të dhënave financiare e statistikore në degët e tatimeve*
- *Ligji mbi akcizën dhe probleme që lidhen me zbatimin e tij në praktike*
- *Mbledhja dhe kontrolli i sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe probleme që lidhen me këtë proces*
- *Shërbimi ndaj tatimpaguesve*
- *Analiza e rrishtit tatimor në kontrollin tatimor dhe disa teknika të thelluara në kontroll për zbulimin e mashtrimit tatimor*
- *Përdorimi i metodave indirekte në kontrollin tatimor për nxjerrjen e rezultatit dhe verifikimin e besueshmërisë së deklaratave të tatimpaguesit*
- *Administrimi i tatimeve dhe reforma në administratën tatimore*

## **Kurse për inspektorët e policisë tatimore**

- *Cështje që lidhen me zbatimin nga policia tatimore të ligjit për sigurimet dhe ligjit për aksizën.*

## **Kurse të tjera trajnimi sipas nevojave të administratës doganore)**

- *Rregullat e origjinës së mallit , certifikata 1 euro*
- *Detyrat funksionale të doganierit –konventa TIR dhe aplikimi i procedurave doganore npm ASSYCUDA*
- *Njohja me legjislacionin e TVSH dhe Akcizës*
- *ToT në lidhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit*

Për vitin 2007, nga Qendra e Trajnimit Fiskal u realizuan **147** kurse, në **254** ditë trajnimi (nga 235 të planifikuara), duke trajnuar **1907** nëpunës të Administratës Tatimore dhe Doganore në nivel qendror dhe lokal.

## **KURRIKULA TË REJA**

Për vitin 2007 u zhvilluan 86 ditë kurrikula të reja në fushën e aftesive dhe per profesione specifike në nivel qendror dhe lokal dhe për administratën fiskale.

Në programin e trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve të pushtetit vendor këtë vit edhe 3 kurrikula të reja për cështje me interes që shoqërojnë procesin e decentralizimit dhe të kalimit të kopetencave nga niveli qendror i qeverisjes në atë vendor. Një vend të rëndësishëm në këtë fushë kanë zënë edhe realizmi i trajnimeve me temë “Qeverisja me pjesmarrje” dhe “Menaxhimi i taksës së biznesit të vogël” hartimi i të cilave dhe zhvillimi i tyre brenda ketij viti për autoritetet vendore u mbështetën financiarisht nga Fondacioni Soros.

Shumica e kurrikulave të zhvilluara nga Qendra e Trajnimit Fiskal per vitin 2007 janë të reja. Tematikat e reja janë “Procedurat e vlerësimit, mbledhjes dhe rimbursimit tatimor dhe manuali procedural”, “Cështje që lidhen me zbatimin nga PT i ligjit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe ligji për akcizat”, “Procedurat e administrimit të sistemit të integruar të tatimeve”, “Tatimi mbi Vlerën e Shtuar”, “Njohuri që lidhen me përdorimin e STI nga punonjësit e AT”, “Rregullat e origjinës së mallit”, “Tatimi mbi akcizat”, “Menaxhimi i borxhit”, “Aspekte të zbatimit të ligjit mbi tatimin mbi të ardhurat”, “Legjislacioni European për TVSH”, “Analiza e Riskut”, etj.

Gjithashtu këtë vit u perfshi në programet e trajnimit në nivel qendror dhe lokal edhe kurrikulla e re “Parandalimi i konfliktit të interesit në Administratën Publike” i realizuar në bashkëpunim me ILDKP.

## **TRAJNERËT**

Është punuar për krijimin e një database më të plotë në lidhje me listën potenciale të trajnereve që aktualisht bashkëpunojnë me Qendrën e Trajnimit të Përgjithshëm dhe

Qendrën e Trajnimit Fiskal. Ka patur një komunikim të vazhdueshëm me institucionet e administratës publike dhe të tjera institucione dhe organizata te cilat ofrojnë eksperte në tregun e trajnimeve. Gjatë vitit 2007 vërehet një shtim i numrit të trajnerëve të rinj dhe një rritje e cilësisë së dhenies së trajnimeve, referuar kjo edhe treguesve të vlerësimit të cilësisë së trajnimit të realizuar nga manaxherët, trajnerët dhe pjesmarrësit.

### ***MJEDISET E TRAJNIMIT***

Si mjedise trajnimi janë përdorur Qendra e Trajnimit Livia dhe Hotel Doro me një shtesë kontrate deri në muajin maj 2007 dhe në vazhdim për sigurimin e mjediseve te trajnimit u realizua procedura e tenderimit “Shërbim me 5 salla trajnimi” duke siguruar salla trajnimi në mjediset e mësipërme. Gjithashtu si mjedise trajnimi kanë shërbyer edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për disa trajnime të zhvilluara nga Qendra e Trajnimit Fiskal, si edhe në rrethe për trajnimet e planifikuara për Pushtetin Vendor dhe Administratën Tatimore .

### ***BASHKËPUNIME DHE PROJEKTE***

#### ***Konferenca e dytë e Shkollës Rajonale të Administratës Publike***

Në Durrës, në datat 3-4 Tetor 2007, u zhvillua Konferenca e dytë Vjetore e “Shkollës Rajonale për Administratën Publike në Ballkanin Perëndimor” (ReSPA) një inisiativë e përbashkët e Bashkimit European dhe e OECD-së, financuar kryesisht nga BE-ja.

Qëllimi i kësaj konference ishte të identifikonte se si duhen zbatuar strategjitë, zbatimimi i të cilave do të bëhet nëpërmjet rregulloreve përkatëse. Kjo sillte si domosdoshmëri ekzaminimin e dy çështjeve: hartimin e rregullatoreve për të garantuar se strategjitë do të arrijnë rezultatet e tyre të pritshme dhe zbatimin në mënyrë që të garantojnë se me të hyrë në fuqi keto rregullore arrijnë rezultatet e tyre të synura.

Konferenca ishte në interes të nëpunësve që kanë lidhje me çdo aspekt të procesit rregullator por përbën interes të veçantë për të gjithë ata që kanë përgjegjësi të nivelit të lartë për zbatimin e strategjive. Konferenca u dha mundësinë pjesëmarrësve të diskutojnë mbi faktin se përse disa strategji, që duhen zbatuar nëpërmjet regjimeve rregullatoreve, janë të suksesshme ndërsa të tjera dështojnë. Theksi u vu gjithashtu mbi forcimin e kapaciteteve dhe të kompetencave për të mundësuar arritjen e regjimeve të mira rregullatore. Duke patur parasysh rolin e ReSPA-s, vëmendje ju kushtua trajnimit të nevojshëm për forcimin e kapaciteteve dhe zhvillimit të këtyre kompetencave.

Pjesmarrës në konferencë ishin përfaqësues nga vende si Shqipëria, Kroacia, Serbia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, të cilat kanë kaluar së fundmi tranzicionin nga ekonomia e centralizuar tek ajo e tregut të lirë dhe tranzicionin gjatë anëtarësimit në BE, si edhe folës nga Ballkani Perëndimor të cilët sollen shembuj praktikë të zbatimit të suksesshëm të strategjive dhe të sfidave që dalin gjatë këtij procesi duke përfshirë ato të forcimit të kapaciteteve.

Shqipëria u përfaqësua në këtë konference në nivel të lartë. Institucionet shqiptare si partner të ReSPA-s në Shqipëri janë Departamenti i Administratës Publike dhe Instituti i

Trajnimit te Administratës Publike që ishte edhe në rolin e bashkëorganizatorit të kësaj konference.

## **Projekti Cards 2004 “Mbështetje për Zhvillimin e ITAP”.**

Projekti përbëhet nga dy komponentë:

**Komponenti i parë** synon “**rikonstruksionin e ndërtesës së re të ITAP**”.

Miratimi i Lejes së ndërtimit nga ana e KRRT të Tiranës, mundësoi edhe realizimin e procedurave të tenderimit për rinovimin e ndërtesës, nga ana e Delegacionit te Komisionit European në Tiranë. Gjithashtu u siguruan fondet e nevojshme për kryerjen e detyrimeve financiare për taksat e ndikimit në infrastrukture dhe është kërkuar fondi për mbulimin TVSH e rimbursueshme, të cilat janë detyrime të Institutit si përfituesi i këtij objekti.

Angazhimet e Institutit në realizimin e këtij projekti vazhdimisht janë konsultuar me përfaqësinë e Delegacionit European në Tiranë, Studion IPROPLAN dhe institucionet perkatës. Pritet që deri në mesin e vitit 2008 ndërtesa e ITAP të perfundojë së rishtrukturuari dhe ITAP të vendosë veprimtarine tij në ndërtesën e re.

**Komponenti i dytë** i këtij projekti fokusohet në sigurimin e asistencës teknike në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve te ITAP në drejtim te menaxhimit të burimeve dhe funksionimin e një “**sistemi trajnimi cilësor**”. Projekti filloi nga muaji Shtator 2007 – dhe do të përfundoj deri në Shkurt 2008.

Përfitimet kryesore të këtij projekti janë:

- draftimi dhe testimi i metodologjive per nje trajnim cilësor dhe menaxhimin e mjeteve;
- dokumenta orientuese për të zhvilluar sistemet e testimit per të qenë të sigurt së të gjitha burimet janë menaxhuar efektivisht, me eficencë dhe me ekonomi maksimale;
- draftimi dhe testimi i standarteve të kontrollit të cilësisë për procedura dhe sisteme më të mira
- trajnime për stafin e ITAP ne lidhje me standartet, cilësinë , indikatorët e matjes së cilësisë së trajnimit.

Vemendje e vecantë në këtë projekt i është kushtuar trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit në lidhje me menaxhimin e procesit te trajnimit.

## **Projekti CARDS – VET 2 (për Arësimin dhe Formimin Profesional)**

Gjatë periudhës raportuese është bashkëpunuar me njësinë e projektit CARDS 2004 për “Arsimin dhe Formimin Profesional” në komponentin: ”Trajnim mbi Kompetencat Themelore”. Projekti, synoi rritjen e aftesive të rreth 150 nëpunësve civilë që operojnë në fushën e Arësimit dhe Formimit Profesional nga Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Arësimit dhe Shkencës, agjensitë e specializuara dhe partnerët e përfshirë në Këshillin Kombetar për AFP.

Gjatë periudhës janë zhvilluar sipas planit të aktivitetet të përcaktuar në marrëveshjen e lidhur midis ITAP dhe “GOPA consultants” në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkoder, Vlorë dhe Korçë, trajnimet e parashikuara. Projekti përfundoi në muajin Prill 2007. Një

raport përfundimtar mbi përfundimin e trajnimit u hartua dhe u depozitua pranë njësisë së projektit “GOPA consultants”.

## **Bashkëpunimi me UNDP**

Ky bashkëpunim ka konsistuar gjatë kësaj periudhe në zhvillimin e trajnimeve të administrates publike në tematika me interes si; “Politikat gjinore të BE dhe Shqipëria”, “Respektimi i të drejtave të Minoriteteve”, “Integrimi Gjinor”.

Gjithashtu përfshirja e tematikave të Perkatësisë Gjinore në programin e trajnimit për të sapoemëruarit në administratën publike mbështetet nga UNDP (matëriali për pjesmarrësit dhe pagesa e trajnerëve).

## **Bashkëpunimi me Fondacionin “Shoqëria e Hapur” për Shqipërinë (SOROS)**

Bashkëpunimi me këtë fondacion për këtë vit ka vazhduar për projektet “**Qeverisja e mirë me pjesmarrje qytetare**” dhe “**Menaxhimi i taksës së biznesit të vogël**”, projekte të cilat janë zbatuar në administratën e qeverisjes vendore. Aktivitetet e parashikuara në këto projekte u zhvilluan duke filluar nga muaji Qershor 2007 deri në fund të vitit 2007.

Të dy projektet kanë përfunduar sipas planit të aktiviteteve të percaktuar dhe për zbatimin e këtyre projekteve u nenshkruan marrëveshjet përkatëse midis ITAP dhe zyrës së Fondacionit SOROS në Tiranë.


## **INDIKATORËT<sup>3</sup>**

Në krahasim me vitin 2006, në mënyrë të përmblodhur, në vitin 2007 janë shënuar tregues më të mirë sasiorë dhe cilësorë, si më poshtë:

<b>Treguesit</b>	<b>2007 Plan</b>	<b>2007 Fakt</b>	<b>2006</b>
Numri i Kurseve	141	<b>288</b>	113
Ditë trajnimi të Zhvilluara	705	<b>798</b>	551
Pjesmarrës në trajnim	2918	<b>4489</b>	1791
Indikatori i Trajnimit: Nëpunës Civil x Ditë trajnimi	9165	<b>12524</b>	8746
Indikatori i Cilësisë së Trajnimit (shkallë 1-7)	6.4	<b>6.42</b>	6.4

<sup>3</sup> Informacione me të hollësishe për treguesit e realizimit të trajnimit **Shtojca 2** (Lista e kurseve dhe treguesit e trajnimit Janar – Dhjetor 2007)





## RAPORTI FINANCIAR

Instituti i Trajnimit te Administrates Publike edhe per vitin 2007 veprimtarine e tij ekonomiko – financiar e mbeshteti ne te ardhurat e Buxhetit te Shtetit. Perdorimi i fondeve u be ne perputhje me Planin e Punes dhe Planin e Trajnimeve per vitin 2007, duke u bazuar ne udhezimin per zbatimin e Buxhetit te Shtetit.

Treguesit financiare te realizuar ne vitin 2007 paraqiten ne menyre te permbledhur si me poshte:

<i>Zerat e Buxhetit</i>	<i>Plani 2007 Ne lek</i>	<i>Realizimi 2007 Ne 000/ lek</i>
600/601 Shpenzime per paga & Sigurime shoqerore	17.905	17.299
602 Shpenzime operative	3.025	2939
602 Sponzorizim _NISPAcee	166	166
230 Shpenzime per Trajnim	12.818	12.670
231 Shpenzime investime	1.967	1944
<b>TOTAL</b>	<b>35.881</b>	<b>35.018</b>

Treguesit e realizimit ne total te planit financiar u realizuan ne masen 98%. Zeri qe ka ndikuar ne uljen e perqindjes se realizimit eshte ai i shpenzimeve per trajnim (230) qe u realizua ne masen 95%. Kjo per arsye se plani i trajnimeve per Qendren e Trajnimit Fiskal ndryshoi ne mesin e vitit 2007 duke zhvendosur trajnimet e parashikuara ne Tirane neper

rrethe. Kjo solli qe shpenzimi per sallat e kontraktuara sipas procedures se tenderimit te mos realizohej ne masen 100%.

## **KONKLUZIONE & REKOMANDIME**

Në përfundim të veprimtarisë vjetore (Janar – Dhjetor 2007) për veprimtarinë trajnuese të ITAP (Qendra e Trajnimit të Përgjithshëm dhe Qendra e Trajnimit Fiskal) dhe zhvillimin e mëtejshëm të institucionit, dalin disa konkluzione dhe sugjerohen disa rekomandime, si me poshtë :

### **Konkluzione:**

Treguesit e trajnimit për periudhen një vjecare janë realizuar tejkaluar në një masë të konsiderueshme ndërsa treguesit financiarë janë realizuar në masën 94%.

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike aktivitetin e tij e bazon në Rregullore e punës së bashku me shtojcat perkatese : “Përshkrimet e punës sipas pozicioneve”, “Proceduart e Punës”, “Rregullore e menaxhimit elektronik te informacionit”. Zbatimi i tyre mbetet detyrë e përhershme e stafit të Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

Faqja e internetit është rikonstruktuar dhe realizuar me qëllim që veprimtaria e qendrave të trajnimit të jetë më e dukshme si edhe përditësimi i materialeve përmbledhëse për kurset dhe programet e trajnimit duke plotësuar interesat e klienteve tanë dhe të interesuarve të tjerë.

Bashkëpunimi me klientët tanë për realizimin e planit të aktiviteteve të ITAP dhe detyrat e parashikuara për vitin 2007 është rritur dhe funksionon.

### **Rekomandime :**

Duhet ti kushtohet një kujdes i vecantë për **CILËSINË** në gjithë aktivitetet e ITAP dhe qendrave trajnuese, (ekspertet, materialet, menaxhimi i trajnimit, ambjentet trajnuese, publikimi i aktiviteteve etj)

Do të ndiqet hap pas hapi realizimi i detyrave të përcaktuara në Planin strategjik 2006-2009 dhe do të monitorohet procesi në vazhdimësi ( sipas objektivave).

Do të synohet rritja e vazhdueshme të kapaciteteve të brendshme të ITAP.

Do të organizohet dhe zhvillohet programi i Trajnimit të Trajnerëve në kuadër të Programit të menaxhimit strategjik parashikuar për menaxherë të nivelit të lartë me qëllim zgjedhjen e trajnerëve /ekspertëve, hartimin e kurrikulës dhe realizimin e trajnimit brenda vitit.

Do të thellohet bashkëpunimi me klientët tanë për realizimin e planit të aktiviteteve të ITAP dhe detyrat e parshikuara për vitin 2008

Do të trajnohen Ministrite e linjes dhe Institucionet e tjera në përdorimin e Manualit të Analizës së Nevojave për Trajnim, me qëllim vënien në funksion të këtij Manuali për përgatitjen e planit strategjik dhe planit të trajnimit për periudhen 2009 - 2012